



Në bazë të nenit 7 të Ligjit për kulturë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15 dhe 39/16) dhe nenit 10, 22 dhe 41 të Ligjit për Qytetin e Shkupit ("Gazeta zyrtare e RM-së nr. 55/04),

QYTETI I SHKUPIT

shpall

THIRRJE PUBLIKE

për mbledhjen e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2020, të dedikuara për financimin dhe përkrahjen e programeve dhe veprimtarisë së institucioneve publike nga fusha e kulturës të themeluara nga Qyteti i Shkupit për vitin 2020

I

Qyteti i Shkupit do të marrë pjesë në financimin dhe përkrahjen e programeve dhe veprimtarive të institucioneve publike nga fusha e kulturës të themeluara nga Qyteti i Shkupit në këto fusha:

- 1.1. Arte performuese
- 1.2. Arte muzikore
- 1.3. Arte vizuale dhe arte të medimeve të reja
- 1.4. Veprimtari botuese dhe bibliotekare
- 1.5. Veprimtari muzeore, promovim i trashëgimisë kulturore
- 1.6. Bashkëpunim ndërkombëtar

II

Qyteti i Shkupit do të marrë pjesë në financimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të institucioneve publike nga fusha e kulturës të themeluara nga Qyteti i Shkupit në përputhje me dispozitat ligjore dhe mbi bazën e qëllimeve dhe kritereve të përgjithshme të mëposhtme:

- ruajtja dhe afirmimi i trashëgimisë materiale, shpirtërore dhe kulturore të qytetit të Shkupit;
- inkurajimi dhe afirmimi i shumëllojshmërisë etnike dhe kulturore;
- ide inovative, mbresëlënëse dhe origjinale;
- kontinuitet i manifestimeve tradicionale kulturore – artistike që janë me interes për qytetin e Shkupit;
- promovim i trashëgimisë kulturore të qytetit të Shkupit;

- prezantim dhe afirmim i krijimtarisë bashkëkohore, kulturës urbane dhe artit publik;
 - kujdesi për infrastrukturën publike në suazat e kulturës dhe stimulimi i medimeve të reja dhe hulumtimeve në kulturë;
 - stimulim dhe përkrahja e projekteve të ndryshme ndërkombëtare;
 - përkrahja dhe zhvillimi i produksionit kulturor tradicional;
 - vendosja e bashkëpunimit në suazat e projektit të propozuar me një ose më shumë institucione kulturore dhe organizata;
 - organizim i festivaleve ndërkombëtare që mbahen në Shkup;
 - shënimi i manifestimeve jubilarë dhe datave të rëndësishme kulturore;
 - publikimi i librave dhe botimeve elektronike, publikimeve, monografive, përmbledhjeve që trajtojnë tema nga jeta dhe historia e Shkupit;
 - projekte qëllimi i të cilave është zhvillimi dhe promovimi i fushave të kulturës dhe industrive kreative;
 - realizimi i filmave dokumentarë që kanë të bëjnë me historinë dhe jetën bashkëkohore në qytetin e Shkupit;
 - nxitja e mendimit shkencor dhe kritik nëpërmjet organizimit të seminareve, konferencave, debateve të cilat trajtojnë tema nga jeta dhe historia e Shkupit;
 - bashkëpunimi dhe pjesëmarrja në manifestime ndërkombëtare, festivale dhe në projekte në bazë të reciprocitetit;
 - programe dhe projekte nga fusha e kulturës që do të zhvillohen në territorin e qytetit të Shkupit dhe të cilat kanë siguruar mjete financiare (grante) nga fondet e Komisionit Evropian, UNESCO ose organizata të tjera ndërkombëtare;
 - bashkëpunim dhe projekte me organizata, institucione dhe individë nga qytetet e binjakëzuara.
- (www.skopje.gov.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=25) – link i portalit zyrtar të Qytetit të Shkupit

III

Mjetet për financimin e veprimtarisë së institucioneve publike dhe programeve të tyre, manifestimeve dhe projekteve përcaktohen me Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2020 dhe me programin vjetor për kulturë.

IV

Paraqitja për Thirrjen publike realizohet me depozitimin e fletëparaqitjes së plotësuar (aplikacionit).

Fletëparaqitjet (aplikacionet) mund të merren në Sektorin për veprimtari publike – Seksionin për kulturë i Qytetit të Shkupit (baraka 2) ose nga ueb-faqja zyrtare e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

V

Thirrja publike do të zgjasë nga 01.06.2019 deri më 30.06.2019, përkatësisht, 30 ditë nga dita e shpalljes në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

Fletëparaqitjet, në formë të shkruar dhe të regjistruara në CD në format Word duhet të depozitohen në Qytetin e Shkupit, nëpërmjet postës në adresën: Bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup, ose në arkivin e Qytetit të Shkupit, deri në orën 18:00 të ditës së fundit të Thirrjes publike (30.06.2019), me

shënimin **“Thirrje publike për mbledhjen e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2020 të dedikuara për financimin dhe përkrahjen e programeve dhe veprimtarive të institucioneve publike nga fusha e kulturës të themeluara nga Qyteti i Shkupit për vitin 2020”**.

Rezultatet e Konkursit, me shpalljen e Programit të miratuar për financimin e programeve dhe projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2020, do të shpallen në “Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” dhe në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk,

Informacione plotësuese mund të merren në telefonat: 02/ 3297 – 324, 02/ 3297 – 289 dhe e-mail adresën e mëposhtme kultura@skopje.gov.mk.

KRYETARI I QYTETIT TË SHKUPIT
